



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.

Prot.

Nr. Dok. 202501822/14

Tiranë / /2025

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave përkatëse për përmirësimin e kushteve infrastrukturore në rrugën: "Mehmet Pashë Plaku", lagjia: "Perash" Shkodër.

Drejtuar: Bashkisë Shkodër
Z. Benet Beci, Kryetar

Shkodër

Për dijeni: Shoqërisë Rajonale Ujësjellës –Kanalizime Shkodër sh.a.
Z. Besmir Lezha, Administrator

Shkodër

Të nderuar!

Sikurse jeni vënë në dijeni nga korrespondenca jonë zyrtare, pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka depozituar një ankesë z. E. B. ndaj Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime, Shkodër, sh.a, në të cilën parashtron ndër të tjera se, ai është banues në rrugën: "Mehmet Pashë Plaku", në qytetin e Shkodrës. Shqetësimi i ngritur prej këtij shtetasi lidhet me faktin e përmbytjes së banesës së tij, si dhe e bllokut të pallateve të ndodhura në zonën ku ai banon, sa herë që ka rreshje të dendura shiu.

Sikundër shkruan, kjo situatë ndodh për shkak se rruga është tejet e amortizuar dhe ka mungesë të kanalizimeve. Edhe pse ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen tuaj për rregullimin e situatës, deri më sot ky problem nuk ka gjetur ende zgjidhje.

Gjendur para kësaj situatë, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje dhe zgjidhjen e këtij problemi, me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të tij të ligjshme.

Pas rregjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore të formës dhe të përmbajtjes për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, respektivisht nenet 13, 17 shkronja "a" dhe 18 shkronja "b", ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

-I-

Qëndrimi i Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër, lidhur me rastin.

Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj çështjeje dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, në vështrim të nenit 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: "*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij*", si dhe në nenin 19, gërma "b" të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit" të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*", me tonën nr. K3/ E11-2 prot., datë 27.05.2024, "kërkesë për shpjegime", i kemi kërkuar Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës -Kanalizime, Shkodër, sh.a, dhënien e shpjegimeve dhe të informacionit sa më konkret dhe gjithëpërfshirës, si dhe dokumentacionin përkatës ligjor lidhur me rastin në fjalë. Konkretisht:

- *A qëndron problematika e parashtruar sa sipër, në lidhje me amortizimin e rrugës si dhe mungesën e kanalizimeve të ujërave të zeza në rrugën: "Mehmet Pashë Plaku", Lagjia "Perash", Shkodër?*
- *Nëse po, na referoni cilat janë shkaqet të cilat kanë ndikuar në krijimin e kësaj situatë?*
- *Çfarë masash konkrete keni ndërmarrë apo mund të ndërmerni për zgjidhjen e kësaj situatë?*

Në kushtet kur ju nuk i jeni përgjigjur kërkesës së mësipërme të Avokatit të Popullit, ju jemi ridrejtuar sërish me shkresat nr. K3/E11-4 prot., datë 26.06.2024 dhe nr. K3/E11-5

prot., datë 19.07.2024 “Kërkesë e përsëritur për shpjegime” dhe në zbatim të nenit 19 paragrafi 2, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, kemi kërkuar që informacioni i mësipërm të na vihet në dispozicion brenda një një afati prej 10 ditësh nga marrja e kësaj shkrese.

Meqenëse sërish nuk morëm përgjigje, edhe pse kishte kaluar afati i përcaktuar, si dhe çdo afat i arsyeshëm kohor ju jemi drejtuar me rekomandimin nr. K3/E11-6 prot., datë 14.10.2024, nëpërmjet të cilit kemi rekomanduar:

- *Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e detyrimit ligjor, për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit.*
- *Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përkatës përgjegjës të Bashkisë Shkodër, lidhur me mospërbushjen e detyrimit ligjor, për t'i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.*
- *Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përkatës përgjegjës Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a., lidhur me mospërbushjen e detyrimit ligjor, për t'i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.*
- *Marrjen e masave organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen.*

Me shkresën më datë 22.10.2024, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, në përgjigje të shkresës sonë na ka informuar se, objekti (ndërtesa) për të cilën ankohet z. E. B. është një zonë e pakualifikuar sa i përket ujërave të bardha dhe të zeza. Zona ndodhet si kuotë nën nivelin e rrugës, ku Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, administron kanalizimet e ujërave të bardha dhe të zeza. Si rrjedhojë kjo zonë ka nevojë për rikualifikim urban. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, është shoqëri e cila me të ardhurat e veta financiare mbulon vetëm shërbime dhe riparime të pjesshme që kanë lidhje me ujërat e bardha dhe të zeza. Në vijim shprehet e gatshme për të bashkëpunuar me institucionet përkatëse në kuadër të mirëmbajtjes së këtij investimi të mundshëm.

Ndërsa me shkresën më datë 19.11.2024, Bashkia Shkodër shprehet ndër të tjera se, në zbatim të VKM-së nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare të riorganizimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, është krijuar shoqëria aksionere rajonale e Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër me NIPT M37819701O. Ky subjekt ushtron veprimtarinë e tij si shoqëri aksionere në zbatim të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Informacioni i kërkuar nga ana juaj është detyrë funksionale e shoqërisë referuar objektit të veprimtarisë së saj.

Pavarësisht kthimit të përgjigjes në aspektin formal, në analizë të saj kemi vlerësuar se, përgjigja e Bashkisë Shkodër nuk ka qenë shteruese, pasi nuk kemi marrë përgjigje për pyetjet e parashtruara nga ana jonë të cilat ne i kemi konsideruar të rëndësishme në kuadër të planit të hetimit administrativ. Në këtë kontekst, me qëllim jo vetëm të identifikimit sa

më të saktë të problematikës konkrete në fjalë, por edhe të zgjidhjes së saj, ju jemi ridrejtuar me shkresën nr. K3/E11-12 prot., datë 06.02.2025, për dërgimin e këtij informacioni nga ana juaj.

Bashkia Shkodër me shkresën më datë 27.02.2025, ka sqaruar ndër të tjera se, zona në fjalë është degëzim i Bulevardit “Mehmet Pashë Plaku”, në të cilën mund të mos jenë bërë investime akoma nga ana e Bashkisë, por të cilat lidhen direkt me planet buxhetore në varësi të prioritetëve dhe të buxheteve të cilat disponojnë njësitë vendore. Sikundër shkruan arsyeja për situatën e krijuar daton që me krijimin e këtij bulevardi, para viteve '90, si pasojë e të cilit është ngritur kuota e rrugës dhe disa shtëpi janë nën kuotën e rrugës, si dhe shkak tjetër mund të jetë se në atë zonë akoma nuk është realizuar rikualifikimi i zonës siç është bërë në shumicën e këtyre zonave që lidhen me Bulevardin “Mehmet Pashë Plaku”. Është i nevojshëm të planifikohet dhe ndiqen procedurat mbi planet buxhetore në varësi të prioritetëve dhe buxheteve të cilat disponojnë njësitë vendore (për përfshirjen në investim) në mënyrë që ky investim të miratohet me vendim të këshillit bashkiak dhe të vijohet me zbatimin e tij.

-II-

Vlerësimi i Avokatit të Popullit, konkluzione dhe rekomandime

Në nenin 108, pika 3, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se, Bashkitë janë njësi bazë e qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisëse me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësitë të tjera të qeverisjes vendore.

Bashkia duhet të luajë një rol sa më proaktiv, udhëhequr nga parimi i autonomisë vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ajo është e veshur me përgjegjësi efektive që mundësojnë një drejtim sa efikas, aq edhe afër qytetarit.

Për t'u rikthyer tek rasti objekt vlerësimi, sa i takon shqetësimit të ngritur nga shtetasi E.B., si një nga banorët e rrugës “Mehmet Pashë Plaku”, lagjia “Perash”, në qytetin e Shkodrës”, Avokati i Popullit vlerëson se infrastruktura është një element me rëndësi kritike për zhvillimin dhe mirëqenien e një komuniteti.

Një ndër Objektivat e Zhvillimit të Qendrushëm¹ të Kombeve të Bashkuara ose (Objektivat Globalë) (SDG9), fokusohet në ndërtimin e infrastrukturës së përshtatshme, reziliente dhe inovative. Vlerësojmë se ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës është thelbësor për rritjen e përgjithshme të mirëqenies dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komunitetit të banorëve të rrugës “Mehmet Pashë Plaku”, lagjia “Perash”, Shkodër, duke e bërë kështu objektivin 9, një prioritet thelbësor në këtë rast.

Ky objektivi lidhet drejtpërdrejtë me përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme dhe sigurimin e mundësive të barabarta, ndaj dhe shqetësimi i ngritur lidhur me mungesën e infrastrukturës bazë, siç është amortizimi i rrugës, përfshihet drejtpërdrejtë në fushën e

¹ Objektivi nr 9 - Ndërtimi i një infrastrukture të fortë, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit.

objektivit 9. Përmbushja e këtyre nevojave përbën një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies së këtij komuniteti pasi është lidhur ngushtësisht me aksesueshmërinë. Në rastin konkret, por jo vetëm, Avokati i Popullit identifikon disa aspekte thelbësore që e bëjnë infrastrukturën një prioritet kyç.

Siç parashikohet në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështeten në veprimtarinë e tyre të përditshme pikërisht në konceptin e *autonomisë vendore*, të kuptuar si “... e drejta dhe aftësia e njësive të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”.

Në nenin 8, të këtij ligji “*Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor*” është parashikuar se, organet e njësive të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohej me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror. Ato ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhrave.

Ndërsa në nenin 9 të tij, është parashikuar si një nga të drejtat dhe përgjegjësitë e Bashkisë edhe ajo e përcaktimit të masave që ajo i gjykon të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave.

Duke analizuar specifikën e këtij rasti dhe korrespondencën zyrtare, Avokati i Popullit evidendon shqetësues faktin se, ndonëse Bashkia Shkodër pranon problematikën e ngritur lidhur me infrastrukturën dhe mungesën e investimeve në lagjen “Perash”, rruga: “Mehmet Pashë Plaku”, ajo nuk planifikon marrjen e masave konkrete për zgjidhjen e kësaj situate. Në këtë kuptim, bashkia nuk ka ushtruar kompetencat e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, për administrimin e rastit. Për pasojë vlerësojmë se, kjo çështje e cila është nën përgjegjësinë tuaj, nuk është adresuar si duhet si dhe në interes të komunitetit. Ne jemi të vetëdijshëm për mundësitë e kufizuara buxhetore, por kjo çështje është tejet sensitive për këta banorë dhe koha e pritjes është shumë e gjatë.

Në ushtrim të funksionit tuaj nuk keni bërë planifikimin dhe financimin përkatës për zgjidhjen e kësaj problematike, duke neglizhuar në këtë mënyrë detyrat funksionale që parashikon ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Evidentojmë se ndër funksionet e **Bashkisë** në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në përputhje me përcaktimin e dhënë në nenin 23, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, është se: “...bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për 1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm; 2. Mbledhjen largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotur; 3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara 4. “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore...”.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj, detyrimin për ushtrimin e detyrave funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen afatgjatë të problemit të infrastrukturës së rrugës “Mehmet Pashë Plaku”, Lagjia:

“Perash”, Shkodër, në përputhje me standardet e kërkuara dhe si një nevojë emergjente për jetesën e këtij komuniteti. Në këtë kontekst vlerësojmë se, kjo lagje ka nevojë për kryerjen e një investimi tërësor që të përfshijë ndërtimin/rehabilitimin e rrugës, duke sistemuar edhe kuotën e rrugës me atë të disa shtëpive që janë nën kuotën e rrugës, si dhe të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza, me qëllim mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut, si dhe mbrojtjen nga përmbytja të zonave të banuara.

Më tej duke u fokusuar në njohjen dhe aplikimin e standardeve ndërkombëtare, theksojmë faktin se Rezoluta 64/292 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, njeh të drejtën për ujë të pijshëm dhe kanalizime të sigurta dhe të pastërta, si një ‘e drejtë e njeriut’ që është thelbësore për gëzimin e plotë të të gjitha të drejtave. Shqipëria është një nga vendet që ka nënshkruar Deklaratën e Mijëvjeçarit duke u angazhuar në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri në vitin 2015 dhe në shtatëmbëdhjetë Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ), të cilat kanë si afat vitin 2030. Në këtë axhendë të re të zhvillimit, uji dhe kanalizimet konsiderohen të kenë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa ato kanë lidhje me disa probleme kryesore globale dhe kanë ndikim në të gjitha aktivitetet njerëzore.

Avokati i Popullit gjen rastin t’u bëjë sërish thirrje autoriteteve shtetërore që të respektojnë dhe garantojnë të drejtën për një mjedis sa më të pastër, të shëndetshëm e të qëndrueshëm, në përputhje edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të deklaruar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në kuadër të Axhendës 2030.

Në këtë kuadër, duke patur parasysh se kjo është një çështje e rëndësishme për komunitetin, Avokati i Popullit konstaton se është thelbësore ndërmarrja e veprimeve konkrete për zgjidhjen e situatës së krijuar. Avokati i Popullit vlerëson se, për të adresuar problemet e evidentuar dhe për të kontribuar në përmirësimin e qasjes, aq më tepër institucionet e pushtetit vendor, duhet të garantojnë standardet më të larta për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve. Investimet në infrastrukturë duhet të shoqërohen me angazhim të komunitetit dhe transparencë në procesin e planifikimit dhe zbatimit të projekteve. Përfshirja e banorëve është kyçe për sigurimin e mbështetjes dhe suksesit të projekteve. Bashkia Shkodër, ka përgjegjësi të rëndësishme për të siguruar që investimet në infrastrukturë të jenë efektive dhe të përshtaten me nevojat reale të komunitetit. Është e rëndësishme që Bashkia të vazhdojë të koordinojë përpjekjet e saj për të siguruar investime të përshtatshme dhe për të përmirësuar jetën e përgjithshme të komunitetit, duke adresuar çështjet e ngritura nga banorët në mënyrë efikase dhe transparente.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe nenin 21, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se : *“ Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit kryen këto veprime ..., b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, c) Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash*

për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”;

REKOMANDOJMË:

- Analizimin e këtij rasti në ushtrim të plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Shkodër si dhe marrjen e masave përkatëse me qëllim përmirësimin e kushteve infrastrukturore në rrugën: “Mehmet Pashë Plaku”, lagjia “Perash”, Shkodër, në kuadër të përmirësimit të jetesës së banorëve të këtij komuniteti në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.
- Kryerjen e një investimi tërësor që të përfshijë ndërtimin/rehabilitimin e rrugës, duke sistemuar edhe kuotën e rrugës me atë të disa shtëpive që janë nën kuotën e rrugës, si dhe të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza, me qëllim mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut, si dhe mbrojtjen nga përmbytja të zonave të banuara.
- Marrjen e masave nga ana juaj për planifikimin në Buxhetin e Bashkisë Shkodër, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme të kryerjes së investimit publik të mësipërm.

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “ Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi, lutemi të na vini në dijeni mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi si dhe masat e marra për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

KOMISIONERE

ERINDA MELI